



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

PROJEKT - VENDIM

Nr. 13, datë 26.07.2018

PËR

NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KKT-SË NR.8, DATË 16.10.2017 “PËR MIRATIMIN E LEJES SË ZHVILLIMIT PËR OBJEKTIN: “RIKUALIFIKIM NË ZONËN URBANE PRANË QENDRËS SË QYTETIT VLORË, RESTAURIMI I MONUMENTEVE TË KULTURËS NË KËTË ZONË DHE RIKONSTRUKSION I OBJEKTEVE TË TJERË EKZISTUES”

Në mbështetje të neneve 28, 29 dhe 113, të Kodit të Procedurave Administrative; neneve 14/1, pika 2, 27 dhe 28, pika 1, të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; neneve 9 dhe 10/1, të Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të Bashkisë Vlorë, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Harta e Planvendosjes së Strukturave, pjesë përbërëse e Vendimit të KKT-së Nr. 8, datë 16.10.2017, “Për miratimin e lejes së zhvillimit për objektin: “Rikualifikim në zonën urbane pranë qendrës së qytetit Vlorë, restaurimi i monumenteve të kulturës në këtë zonë dhe rikonstruksion i objekteve të tjerë ekzistues”, zëvendësohet me Hartën e Planvendosjes së Strukturave bashkangjitur këtij vendimi.
2. Procedurat administrative/ligjore të përmendura në Vendimin e KKT-së Nr. 8, datë 16.10.2017, “Për miratimin e lejes së zhvillimit për objektin: “Rikualifikim në zonën urbane pranë qendrës së qytetit Vlorë, restaurimi i monumenteve të kulturës në këtë zonë dhe rikonstruksion i objekteve të tjerë ekzistues”, do të vijohen nga Bashkia Vlorë, sipas përcaktimeve dhe rregullave të parashikuara në dispozitat e Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar dhe VKM-së Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, në përputhje me “Marrëveshjen për Delegimin e Kompetencave” të nënshkruar mes Kryetarit të Këshillit

Kombëtar të Territorit dhe Kryetarit të Bashkisë Vlorë, në datë 16.10.2017, si dhe ndryshimin e saj, bashkëlidhur këtij Vendimi.

3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Bashkia Vlorë, për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA

DRAMA

MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I KULTURËS

MIRELA KUMBARO

ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA